Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit:
Edukim Inkluziv

Niveli i studimeve:
Master

Numri i kredive:
60 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

PËRMBAJTJA:

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT 3

2. REZULTATET E PRITSHME 4

3. PASQYRA E PROGRAMIT: Edukimi inkluziv 5

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS 6

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Fakulteti i Edukimit, si institucion për kualifikimin e mësimdhënësve të të gjitha profileve e niveleve, ka për qëllim të ofrojë mundësi për avancim profesional të mësimdhënësve të rregullt apo mbështetës për të adresuar aspektet e gjithëpërfshirjes në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë. Për këtë arsye ky program ofrohet si reagim pozitiv ndaj realiteti të krijuar.

Qëllimet specifike të programit janë:

- Përgatitja e studentëve për të qenë kontribuues aktivë në procesin e realizimit të gjithëpërfshirjes në sistemin parauniversitar;

- përgatitja e studentëve, të cilët, si mësimdhënës, do të promovojnë ambient të përshtatshëm për të nxënë për të gjithë studentët;

- përgatitja e studentëve për të zhvilluar njohuri kritike ndaj dimensioneve teorike dhe praktike në proceset inkluzive;

- avancimi i njohurive dhe shkathtësive pedagogjike për të nxënit potencial të nxënësve, duke ndërvepruar me dinamikat e punës individuale dhe menaxhimin e grupit të integruar në procesin e gjithëpërfshirjes;

- demonstrimi i gatishmërisë dhe i shktathtësive për zhvillimin e projekteve në institucionet arsimore;

- zhvillimi i shkathtësive për hulumtime në mjedise shkollore dhe më gjerë.

2. REZULTATET E PRITSHME

Me përfundimin e suksesshëm të programit të studimeve, studentët do të jenë në gjendje:

- Të rishikojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe gjykojnë për njohuritë dhe aftësitë e veçanta, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme dhe prapavijën e nxënësve.

- Të promovojnë një ambient të përshtatshëm për të nxënit për të gjithë nxënësit dhe të mundësojnë marrëdhënie të përkujdesjes edukative, individuale dhe me tërë klasën.

- Të zhvillojnë vetëdije kritike për të qenë facilitues të inkluzionit, të mbështesin çështjet specifike të inkluzionit, si p.sh: nevojat për arsim special, fëmijët e talentuar, dallimet gjinore, dallimet kulturore, etj., të identifikojnë me kompetencë situatat komplekse, duke intervenuar në kontekste të ndryshme.

- Të zhvillojnë të kuptuar, të avancuar dhe përgjigje kritike ndaj dimensioneve teorike, metodologjive, praktikave dhe teknologjisë në proceset inkluzive për të sjellë të reja në kontekstin edukativ dhe normativ, nën të cilin veprojnë mësimdhënësit dhe shkollat.

- Të monitorojnë dhe vlerësojnë intervenimet edukative, proceset inkluzive dhe praktikën pedagogjike përmes analizave dhe aktiviteteve shkollore.

- Të demonstrojnë përgjegjësi personale për zhvillimin e vet profesional, duke reflektuar në mënyrë kritike mbi përvojën personale, nevojat institucionale dhe politikat kombëtare.

- Të shfaqin të kuptuar, të avancuar dhe shkathtësi për të ndërvepruar me dinamikat familjare dhe të zbulojnë modalitetet e përfshirjes dhe bashkëpunimit me familjet, komunitetet dhe rrjetet e shërbimeve edukative, sociale dhe shëndetësore.

- Të tregojnë njohuri dhe shkathtësi pedagogjike-didaktike për promovimin e të nxënit potencial të nxënësve në procesin e gjithpërfshirjes në klasë dhe menaxhimin e grupit të integruar të klasës.

- Të demonstrojnë gatishmëri dhe shkathtësi për hulumtime në edukim, në shkollë dhe mjedise të tjera.

- Të demonstrojnë shkathtësi pedagogjike në zhvillimin e projekteve në veçanti për Planin Individual të Edukimit.

3. PASQYRA E PROGRAMIT: Edukimi inkluziv

VITI I PARË

SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Kurs i avancuar në edukim inkluziv dhe legjislacioni	O	3+1	5
2.	Bazat e logopedisë	O	2+2	5
3.	Zhvillimi atipik	O	2+1	5
4.	Laboratori	O	1+3	5
5.	Edukimi ndërkulturor	Z	2+2	5
6.	Mësimdhënia e diferencuar dhe plani individual i edukimit (PIE)	Z	2+2	5
7.	Bashkëpunimi midis familjes, institucioneve dhe ekspertëve	Z	2+2	5
8.	Modelet e integruara të intervenimit psiko-pedagogjik	Z	2+2	5
	Gjithsej		**12+11**	**30**

SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodologji e hulumtimit në edukimin inkluziv	O	2+2	5
2.	Vështirësitë specifike në të nxënë	O	2+2	5
3.	Krijimi dhe menaxhimi i klasës inkluzive	Z	2+2	4
4.	Praktikë e avancuar dhe TIK për edukim inkluziv	Z	2+2	4
5.	Çrregullimet sociale, emocionale dhe në sjellje	Z	2+2	4
6.	Praktika (përfshirë të gjitha fushat edukative)	O	3+1	6
7.	Teza e masterit	O		10
	Gjithsej		**9+7**	**30**

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

	Përshkrimi për secilin kurs
1	Kurs i avancuar në edukim inkluziv dhe legjislacioni
	Ky kurs është i dizajnuar për të adresuar nevojat e zhvillimit profesional të studentëve me interes të veçantë në arsimin gjithëpërfshirës. Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të edukimit inkluziv në vende të ndryshme të botës, duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Në pjesën e dytë ofron njohuri rreth legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar për inkluzionin dhe politikat implementuese. Në këtë kurs do të analizohen dokumentet më relevante ndërkombëtare, të cilat promovojnë inkluzionin, si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1949); Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989); Deklarata Botërore për Arsimim për të gjithë, (1990); Deklarata e Salamankës (1994); Akti i Arsimit (1996); Deklarata Botërore e Dakarit për Arsimim për të gjithë (2000); EFA (Education for All) – Arsimimi për të gjithë (2001); Dokumenti Konceptual i UNESCO- s për Arsimin Gjithëpërfshirës (2002); Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore (2005); Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Nevoja të Veçanta (2007). Pastaj dokumentet kosovare, ligjet si: Ligji për Arsimin Parauniversitar (2011), Ligji për Arsimin e Lartë (2011), Korniza e Kurrikulës e Kosovës (2011), sikurse edhe Planet Strategjike për arsimin parauniversitar në Kosovë të hartuara nga MASHT-i. Ndërsa, në mënyrë të veçantë do të trajtohet edhe Indeksi për inkluzion.
2	Bazat e logopedisë
	Kursi ka të bëjë me *logopedinë*, e cila është shkencë klinike-laboratorike dhe shoqërore-fenomenologjike, që hulumton patologjinë e komunikimit verbal-tingullor të njeriut, me qëllim të parandalimit, vlerësimit, diagnostikimit dhe të intervenimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në individin, si dhe për arsye të hulumtimit të kësaj hapësire me qëllim të përshkrimit, përcaktimit, sqarimit dhe veprimit shkencor-profesional. Ky kurs ka të bëjë gjithashtu edhe me *çrregullimet e të folurit*, përkatësisht me: belbëzimin, dizartrinë, clateringun, çrregullimet e të artikuluarit dhe fonologjike, çrregullimet gjuhësore te fëmijët, afazionin, apraksinë e të folurit, çarjen e qiellzës, të folurit e fëmijëve me retardim mental, autizëm, paralizë cerebrale, dëmtime të të dëgjuarit, si dhe çrregullime të zërit. Në kuadër të këtij kursi përfshihen edhe *metodat dhe instrumentet e ndryshme të komunikimit* që ndërlidhen me vëzhgimin si teknikë për identifikimin e nevojave të fëmijëve me çrregullime të ndryshme të komunikimit verbal dhe joverbal.

3	Zhvillimi atipik
	Kursi përmban konceptet bazike mbi zhvillimin në fëmijëri dhe çrregullimet që mund të paraqiten gjatë zhvillimit, të cilat mund të derivojnë në nevoja të veçanta edukative (N.V.E). Në kurs ofrohet një analizë e natyrës, origjinës, rrjedhoja e zhvillimit dhe trajtimi/ ndërhyrja e zhvillimit atipik përgjatë fëmijërisë deri në adoleshencë. Patologjitë zhvillimore të asociuara me çrregullimet biologjike, neurologjike si dhe atyre të faktorëve të jashtëm apo mjedisorë. Brenda këtyre çrregullimeve mund të përfshihen, raitardimi apo ngecja në zhvillimin mendor, paraliza cerebrale, çrregullimet e zhvillimeve motorike, vizuale, dhe auditive. Jo vetëm mangësitë, por edhe zhvillimi më i përparuar apo dhuntitë, merren parasysh brenda një zhvillimi atipik, sepse supozojnë një adaptim të mjedisit. Ndërsa në ato të ndikuara nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, mund të përfshijmë, autizmin, çrregullimin e vëmendjes me ose pa hiperaktivitet, çrregullimet specifike të të nxënit. Pra, qëllimi i këtij kursi është që t'u ofrojë studentëve një hyrje në fushën e psikopatologjisë zhvillimore dhe studimin e problemeve psikologjike në kontekstin e zhvillimit njerëzor.
4	Laboratori
	Studentët e përfshirë në këtë program, e para, do të jenë kompetentë për të përfshirë në proces mësimor fëmijët/ nxënësit me nevoja të veçanta; ata do të mësojnë për të zhvilluar tipare pozitive të diferencave, të punojnë për të gjeneruar kualitetet personale dhe të krijojnë një klimë të zgjeruar të bashkëpunimit në mes mësimdhënësit të klasës dhe asistentit të mësimdhënësit. Ushtrimet/trajnimet në laborator organizohen në fushat psiko-pedagogjike, metodologjike e didaktike, sociologjike-antropologjike dhe digjitale. Kurrikula, gjithashtu, ofron aspekt (fushë) të trajnimit duke shfaqur përkushtim për thellimin e përmbajtjes, e cila do të jetë subjekt i mësimit në nivele të ndryshme arsimore (njohuritë e shkollës). Aspekti (fusha) i tretë ka të bëjë me gjithëpërfshirjen e plotë të nxënësve me nevoja të veçanta. Për secilën nga aspektet (fushat), e këto janë laboratorët që lejojnë (aftësojnë) studentët për të aplikuar njohuritë e fituara në kurse, për shembull, në zhvillimin e materialeve të trajnimit, ndërtimin e mjeteve, në zhvillim të kapacitetit reflektues, kritik dhe përmes punës në grup dhe diskutimeve bashkëpunuese.
5	Edukimi ndërkulturor
	Kursi ofron njohuri për diversitetin kulturor në shoqëri të ndryshme dhe format e edukimit ndërkulturor. Në kuadër të këtij kursi trajtohen tema që kanë të bëjnë me të kuptuarit e termave: interkulturalizëm, multikulturalizëm, plukulturalizëm

	e transkulturalizëm dhe përmbajtjen e edukimit kulturor: paqe, zhvillim, bashkëjetesë, qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu, ofrohen përmbajtje lidhur me kulturat e ndryshme në shoqëri, për zhvillimin e edukimit ndërkulturor në Evropë, qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë individëve pa dallim, për qëllimin dhe dobitë e edukimit ndërkulturor, kontekstet kulturore, etj.
6	Mësimdhënia e diferencuar dhe Plani individual i edukimit (PIE)
	Kursi është i dizajnuar për të siguruar që studentët të aftësohen për të projektuar një mjedis mësimor që plotëson nevojat e ndryshme të nxënësve. Përmes këtij kursi ofrohen përmbajtje që mundësojnë një kuptim të tri komponentëve të mësimdhënies së diferencuar: a. përmbajtje, b. proces dhe c. produkt. Kursi adreson çështje të udhëzimeve për menaxhim të klasës së diferencuar që të planifikojë në mënyrë efektive një plan pune (udhëzues) për mësim të diferencuar, duke zbatuar strategji dhe aktivitete të diferencuara që plotësojnë nevojat e nxënësve në të gjitha nivelet. Gjithashtu, përmes këtij kursi do të ofrohen njohuri e shkathtësi për hartimin e Planit Individual të Edukimit për nxënësit me nevoja të veçanta, duke përfshirë edhe nxënësit e talentuar.
7	Bashkëpunimi midis familjes, institucioneve dhe ekspertëve
	Duke filluar nga optika sistemike - relacionale, në këtë kurs diskutohet për temat, si: angazhimi i kujdesit arsimor për personat me nevoja të veçanta dhe familjen e tij, gjithëpërfshirjen sociale-punuese me një rishikim të projektit të jetës, kuptimin dhe implikimet që dalin nga njohja e identitetit. Për një person me nevoja të veçanta për t'u përfshirë në një kontekst arsimor do të thotë marrëdhënie dhe përfshirje e shumë protagonistëve, përkatësisht, shumë subjekteve. Hyrja në rrjetin social, nuk nënkupton vetëm mirëpritje, ndihmë, kujdes, por ajo mund të sjellë edhe burime që është në gjendje t'i zbatojë dhe mund të ofrojë për komunitetin dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në rrjetin social. Përveç kësaj, analizohen edhe ligjet më të rëndësishme për përfshirjen sociale të njerëzve me nevoja të veçanta dhe do të paraqiten "praktikat më të mira", të cilat dëshmojnë përfshirjen e personit me nevoja të veçanta .
8	Modelet e integruara të intervenimit psiko-pedagogjik
	Kursi *Modelet e intergruara të intervenimit psiko-pedagogjik* në aftësinë e kufizuar intelektuale dhe çrregullimet zhvillimore do të organizohet në tri module të ndara. Moduli i parë synon të zhvillojë të menduarit kritik të studentëve lidhur me kornizat teorike të procesimit të informacioneve bihejvioriste, social-kognitive dhe ekologjike dhe aplikimin e tyre në edukimin inkluziv. Moduli i dytë përqendrohet në analizën dhe sintezën e intervenimeve

	psikologjike, që rrjedhin nga këto teori dhe ndërlidhja e tyre me procesin e edukimit. Së fundmi, moduli i tretë fokusohet në aplikimin e dy moduleve të para në të kuptuarit dhe intervenimet drejt aftësisë së kufizuar intelektuale dhe çrregullimeve zhvillimore. Përftimi i njohurive mbi kornizat teorike të zhvillimit dhe ndërveprimit të individit me strukturat më të larta sociale (familja, shoqëria, kultura); të kuptuarit e parimeve dhe teknikave të intervenimit psiko-edukativ; njohja me çështjet bashkëkohore të lidhura me intervenimet psiko-edukative drejt aftësisë së kufizuar intelektuale dhe çrregullimeve zhvillimore.
9	Metodologjia e hulumtimit në edukimin inkluziv
	Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e hulumtimeve pedagogjike. Në kuadër të këtij kursi ofrohen përmbajtje për qasjen kuantitative dhe kualitative të hulumtimit. Kursi ofron tema përkitazi me metodat kuantitative dhe kualitative të hulumtimit: metoda eksperimentale, metoda e vëzhgimit, intervista e strukturuar, fokus-grupi, studim rasti, etj., procedurat, hapat e hulumtimit, analiza e të dhënave etj. Të gjitha këto metoda ilustrohen me shembuj praktikë nga hulumtimet në institucionet arsimore me theks të veçantë në fushën e edukimit inkluziv dhe të didaktikës. Përmes trajtimit të temave, zhvillohen shkathtësi të organizimit të hulumtimeve, përdorimit efikas të metodave kuantitative dhe kualitative, analizës së të dhënave dhe shkathtësi të shkrimit akademik, duke thelluar njohuritë e temave të caktuara të inkluzionit varësisht nga interesimi i studentit.
10	Vështirësitë specifike në të nxënë
	Kursi ka të bëjë me *vështirësitë specifike në të nxënë*, përkatësisht me: disleksinë, disgrafinë, diskalkulinë, si dhe me çrregullimet në lexim dhe shkrim në moshën parashkollore, shkollore dhe atë të rritur. Në kurs shtjellohen simptomat dhe shkaktarët e vështirësive specifike në lexim, shkrim dhe matematikë. Pastaj, vështirësitë në të nxënë si pasojë e çrregullimeve në të folur dhe gjuhë, dëmtimeve në të dëgjuar, dëmtimeve në të parë, prapambetjes intelektuale, si dhe çrregullimeve emocionale dhe atyre të sjelljes. Kursi përfshin edhe *metodat dhe instrumentet e ndryshme* për identifikimin dhe vlerësimin e hershëm të fëmijëve me çrregullime në lexim dhe shkrim. Këtu përfshihen edhe masat e domosdoshme për edukimin dhe arsimimin e denjë të fëmijëve të moshës shkollore dhe të rriturve me çrregullime të tilla.
11	Krijimi dhe menaxhimi i klasës inkluzive
	Kursi është dizajnuar në mënyrë që studentët të kuptojnë domethënien e klasës inkluzive dhe adresimin e udhëzimeve relevante për një funksionim të efektshëm të klasës inkluzive. Në këtë kurs trajtohen tema që u referohen diversiteteve të

	nxënësve në klasë, krijimin e klasës në mënyrë që të gjithë nxënësit të ndjehen të mirëseardhur pavarësisht kombit, gjuhës, gjinisë apo diversiteteve të ndryshme si pasojë e dëmtimeve të natyrave të ndryshme fizike, psikike e emocionale dhe sociale. Gjithashtu, ofrohen edhe modele për zbatim të suksesshëm të praktikave të mira në një klasë inkluzive, duke përfshirë edhe menaxhimin e sjelljes dhe të disiplinës në klasë.
12	Praktikë e avancuar dhe TIK për edukim inkluziv
	Në didaktikë, si një disiplinë pedagogjike me gjithë dimensionet teorike dhe praktike, si dhe me kompleksitetin e një shoqërie në të cilën arsimi formal, joformal dhe informal janë gjithnjë e më të ndërlidhur, çështja e teknologjive arsimore dhe transformimi i mjeteve të komunikimit pedagogjik dhe ekspansioni, përkatësisht, zhvillimi i përgjithshëm determinon edhe ridefinimin e vetë konceptit të arsimit. TIK-u në mënyrë kritike analizon të gjitha mundësitë instrumentale dhe metodologjike përmes së cilës mësimdhënësit ushtrojnë të drejtën dhe detyrën e tyre për të zgjedhur sipas cilësisë së objektivave të shërbimeve dhe projekteve në të cilat operojnë edhe përmbajtjet specifike të programit të tyre studimor/trajnues. Prandaj, analizohen konceptet multimediale dhe interaktive në mjedise të reja të të nxënit, adresohen problemet e kualifikimit teknologjik të përvojës arsimore, duke jetuar në kontekstin e ri të zhvillimit të pajisjeve për të identifikuar mundësi të reja për mësim profesional për mësuesit që janë kompetentë për të lëvizur në mënyrë të ndërgjegjshme në mjedis kompleks të teknologjive të reja të destinuara si mjete të përfshirjes .
13	Çrregullimet sociale, emocionale dhe në sjellje
	Ky kurs përmbledh çështjet mbi zhvillimin social dhe emocional, ku familja luan një rol primar në kontekstin socializimit në pjesët e para të jetës dhe, si e tillë, mban një çelës themelore për të kuptuar origjinën e rezultateve të përshtatjes dhe të mospërshtatjes psikologjike, emocionale dhe ndërpersonale të fëmijëve. Çrregullimet emocionale te fëmijët kanë prejardhje të ndryshme, mirëpo atë që mësuesit apo ndërvepruesit më të shpeshtë më fëmijët mund të njohin apo dinë, janë si pasojë e një përdorimi jo të mirë të gjuhës verbale dhe joverbale. Andaj, rregullat sociale dhe stabilizimi i tyre më së miri mësohen dhe transmetohen përmes gjuhës. Problemet e sjelljes, shpesh janë si shkaktarë e shpesh si pasojë e një komunikimi të çrregullt.
14	Praktika e mësimdhënies
	Qëllimi parësor i komponentit të mësimit praktik është që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për disenjimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë gjithëpërfshirëse. Përmes praktikës studentët

do të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës. Komponenti i mësimit praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:

1) Mësimin praktik në fakultet, i cili ka tri qëllime primare:
- t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa gjithëpërfshirëse;
- t'u ofrojë studentëve mundësi të njohin dhe zhvillojnë shkathtësi, qoftë si edukatorë, mësimdhënës, qoftë si pedagogë në institucione parashkollore, klasa parafillore, shkolla të niveleve të ndryshme, qendra burimore, dhoma burimore dhe institucione të tjera edukative e arsimore;
- t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë.

2) Mësimi praktik në institucione parashkollore dhe shkolla synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë edukatorë, mësimdhënës në nivelin e shkollës fillore, të mesme të ulët dhe/ose të lartë dhe pedagogë, qoftë në rolin e pedagogut të shkollës, qoftë në rolin e mësimdhënësit mbështetës, intenerar, etj., me qëllim të krijimit të një ambienti gjithëpërfshirës fizik, social e pedagogjik.

Përderisa mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e mësimit praktik në shkolla realizohet nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit. Kjo do të mundësojë edhe një ndërlidhje me laboratorët, që do t'u mundësojë studentëve të zhvillohen bashkërisht me mësimdhënës mentorë apo mësimdhënës të vlerësuar, të cilët posedojnë shkathtësi të menaxhimit të ushtrimeve dhe situatave autentike e simulative në ambientet e Fakultetit të Edukimit.
Mësimi praktik për studentët e këtij programi do të realizohet gjatë muajit shkurt, para fillimit të semestrit të dytë dhe do të zgjasë 2 javë. Gjatë kësaj periudhe do të kombinohet mësimi praktik në fakultet me mësimin praktik në shkolla, duke u bazuar në Doracakun e mësimit praktik dhe në udhëzimet e veçanta të përgatitura nga mësimdhënës të fakultetit në bashkëpunim me mësimdhënës të institucioneve arsimore të përzgjedhur si bashkëpunëtorë potencialë.
Gjatë mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet vijuese:

Portofolion. Një portofolio për vëzhgimet në institucione arsimore dhe planet e

	njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto etj.), të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore në klasa në institucione parashkollore, fillore, qendra burimore apo dhoma burimore *Ditarin e studentit mësimdhënës.* Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv, duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura. *Ditarin e mbikëqyrësit.* Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur në të cilin mësimdhënësi mentor dhe mbikëqyrësit e Universitetit shkruajnë të dhënat e vrojtimit dhe shënimet. Këto dokumente do të jenë bazë për vlerësimin e studentit
15	Teza e masterit
	Tema e masterit përmban 10 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të Programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit. Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere: 1. Tema duhet të ketë 15, 000 – 20, 000 fjalë, në fontin 12, *Times New Roman.* 2. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association). 3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në profilin e caktuar. 4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe për të bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse. 5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse. 6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiumit varësisht si përcaktohet me aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet

për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.

7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të Fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.

8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.

9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.

10. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati.

Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.